



Prishtinë: 12.02.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1237_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2010_12_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.01.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 12.02.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin E. S. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR - 90073446 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2009_12_19** i datës 17.12.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.01.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: korrigjimi plotësues i datës 26.12.2018 është korrigjim i saktë dhe real, bazuar në rregullat dhe ligjet në fuqi. KESCO në ankesë ka theksuar se nuk pajtohet me argumentet e DMK në ZRRE që 09/2018 duhet të përfshihet në korrigjim, ndërsa për periudhën 08/2018 thekson se nuk duhet të merret parasysh kur dihet se nuk ka shpenzim të energjisë elektrike ajo periudhë. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2010_12_19 i datës 17.12.2019 për konsumatorin E. S. me shifër DPR - 90073446.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s korrigjimi plotësues i datës 26.12.2018 është korrigjim i saktë dhe real, bazuar në rregullat dhe ligjet në fuqi, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron pasi që bazuar në procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0801980 të datës 15.11.2018 si dhe procesverbalit të shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.33508 të datës 10.12.2018 konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi edhe për periudhën shator 2018 pasi që fatura e periudhës shtator 2018 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit. Pra Bordi i ZRRE thekson se konstatimi i organit të shkallës së parë lidhur me atë se korrigjimi i KESCO i datës 26.12.2018 nuk është i saktë është plotësisht i drejtë pasi KESCO nuk ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës gjatë korrigjimit të konsumatorit.



Bordi i ZRRE thekson se konstatimi që njehsori elektrik nuk ka regjistruar saktë shpenzim të energjisë elektrike në atë periudha e dëshmon edhe fakti se në procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.33508 të datës 10.12.2018 është evidentuar vërejtja që njehsori elektrik ka të hapur kapakun kryesor gjatë testimit të parë në laborator me datë 13.09.2010, regjistron energjinë pa ngarkesë por nuk mund të dihet vlera e saj, në rryma të vogla regjistron me shumë energji kurse në rryma të mëdha më pak.

Bordi i ZRRE thekson se gjithashtu ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit të periudhave kontestuese me periudhat e më hershme dhe të më vonshme me dy njehsorë elektrik, njehsorin e vjetër nr.38444327 dhe njehsorin e ri nr.64639152 dhe konstaton se konsumatori ka luhajtje të madhe në shpenzimin e energjisë. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimi i konsumatorit për periudhat e më hershme të njëjta me njehsorin elektrik nr.38444327 janë: periudhën 08/2017 është 0 kWh, periudhën 09/2017 është 26 kWh, periudhën 10/2017 është 369 kWh, kurse me njehsorin e ri nr.64639152 për periudhat e mëvonshme periudhën 08/2019 është 178 kWh, periudhën 09/2019 është 162 kWh, periudhën 10/2019 është 211 kWh si dhe periudhën 11/2019 është 331 kWh.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se nuk pajtohet me argumentet e DMK në ZRRE që 09/2018 duhet të përfshihet në korigjim, ndërsa për periudhën 08/2018 thekson se nuk duhet të merret parasysh kur dihet se nuk ka shpenzim të energjisë elektrike ajo periudhë. Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk qëndron pasi që ashtu siç u theksuar edhe më lartë konstaton se konsumatori ka pasur çrregullime nga periudha gusht 2018 deri në periudhën e ndërrimit të njehsorit elektrik 11/2018 pasi që shpenzimi i faturuar për këto periudha nuk korrespondon me shpenzimet reale të konsumatorit, dhe kjo lehtë vërtetohet edhe me shpenzimet e konsumatorit të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike. Bordi i ZRRE-së thekson se korigjimi i KESCO është bërë vetëm për 10/2018 dhe 11/2018 e kjo bazuar në shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit të periudhës 10/11/2017 dhe nuk ka përfshirë në korigjimi periudhën shtator 2018, ndërsa organi i shkallës së parë ka theksuar se korigjimi duhet të jetë duke përfshirë faturat 09/10/11/2018 (15.11.2018) e kjo bazuar në shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit të periudhës 09/10/11/2017. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE thekson se pas analizave të bëra të gjitha shkresave të lëndës konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë të ZRRE ku është vendosur që të bëjë korigjimi i faturave 09/10/11/2018 (15.11.2018) në vlerë - 849.47€ është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit E. S. dhe
- Arkivit të ZRRE-së